



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Dorezuar Priljena / Prudato Received / Delivery	12-05	2021	viti god year
Organ / Njësia Organ / Jednica Org / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKM/SHCK	2378/2021		1/2



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.252/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktari-kryetare, Jeton Koca dhe Eshref Shabani-anëtarë, si dhe Ardita Perçuku-Shyti-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.252/2021 të datës 06.04.2021, të parashtruar nga ankuesja _____ me adresë, rruga "Demir Vitija" nr.64, Komuna e Prishtinës, kundër organit të punësimit Zyra Kombëtare e Auditimit, në çështjen juridike "*kontestim konkursi*" duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datën 11.05.2021, mori këtë:

V E N D I M

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Shpallet jo kompetent për të vendosur lidhur me ankesën me numër A.nr.252/2021 të datës 06.04.2021, të parashtruar nga ankuesja _____

A r s y e t i m

Ankuesja _____ e punësuar në Zyrën Kombëtare të Auditimit sipas kontratës me numër protokollit : 1950 të datës 07.09.2018, në pozitën "Auditor i Performancës", ka aplikuar në konkursin e datës 24.02.2021 të shpallur nga Zyra Kombëtare e Auditimit për pozitën "Auditor Senior për Auditimin e Performancës".

Ankuesja _____ pakënaqur me mos përfshirjen e saj në listën e ngushtë nga ana e Komisionit Përzgjedhës të Zyrës Kombëtare të Auditimit, me datën 11.03.2021 ka parashtruar ankesë në Komisionin për Zgjedhjen e Ankesave të Zyrës Kombëtare të Auditimit.

Komisioni për Zgjedhjen e Ankesave të Zyrës Kombëtare të Auditimit, me datën 18.03.2021, ka nxjerr vendim me të cilin e ka refuzuar ankesën e ankueses si të pabazuar.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova: Ankesën me Nr. Prot:1611/2021 e datës 06.04.2021 e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; E-maili zyrtar i datës 04.06.2021; Ankesë e ankueses e datës 11.03.2021, drejtuar Komisionit për Zgjedhjen e Ankesave të Zyrës Kombëtare të Auditimit; Vendim i datës _____



10.05.2021 I KOMISIONI PËR ANKESAT ZYRTARE TË AUDITIMIT, E-maili zyrtar i datës 20.10.2020, E-maili zyrtar i datës 28.08.2020; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë për periudhën audituese 2019/2020; E-maili zyrtar i datës 27.08.2020; E-maili zyrtar i datës 13.11.2020; Akt emërimi i ankueses me numër Nr.11401 i datës 01.04.2014; Vendim i datës 07.10.2019, për emërimin e ankueses në funksionin e Udhëheqëses në ekipin e auditimit të performancës; Kontratë pune për kohë të pacaktuar e ankueses e datës 09.06.2017.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha provat e lëndës, ka konstatuar se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, *nuk është kompetent* për të vendosur për ankesën e parashtruar nga ankuesja *sepse:*

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, duke u bazuar në provat e lëndës, ka konstatuar se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nuk është kompetent për shqyrtimin e kësaj çështje, pasi që ankuesja mban pozitën "Auditor i Performancës", në Zyrën Kombëtare të Auditimit, si dhe pozita për të cilën ka aplikuar ankuesja "Auditor Senior për Auditimin e Performancës", nuk hyn në kategorinë e pozitave të nëpunësve civil, respektivisht janë përjashtuar nga kjo kategori me nenin 15 paragrafin 1 të Ligjit Nr.05./L-055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës, i cili përcakton se : *"Legjislacioni përkatës për shërbimin civil, nuk zbatohet vetëm për Auditorin e Përgjithshëm, Zëvendës auditorin e përgjithshëm, Ndihmës auditorët e përgjithshëm dhe Auditorët e Zyrës Kombëtare të Auditimit, ndërsa stafi tjetër trajtohet në baze të Ligjit për Shërbimin Civil"*.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.252/2021

Ardita Perçuku-SHYTI

Ardita Perçuku
Procesmbajtëse

Malsore Gashi-BAJRAKTARI

Malsore Gashi
Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankueses;
- Auditorit të Përgjithshëm në Zyrën Kombëtare të Auditimit;
- Udhëheqësit të Personelit në Zyrën Kombëtare të Auditimit; dhe
- Arkivit të KPMSHCK- së;

